

A mund të marrësh fetva nga secili medhheb (shkollë juridike)?

Dr. Hatem el-Haj

<http://www.drhatemalhaj.com/home/can-we-mix-between-the-madhahib/>

Teksa citon dijetarët e mëhershëm, Imam Ibn Tejmije thotë:

“Konsensusi i dijetarëve është provë e prerë dhe dallimi i tyre rreth vendimeve juridike është një mëshirë e madhe.”¹

Gjerësia e trashëgimisë sonë juridike dhe dallimet e shumta mes medhhebeve dhe muxhtehidëve të pavarur u shkaktojnë bezdi disa studentëve të Fikhut (jurisprudencës islame) dhe juristëve të rinj. Mirëpo, kjo përbën burimin kryesor të fleksibilitetit që mundëson përtëritje. Shumë ndjekës të katër medhhebeve më të njohura kanë lejuar transferimin (*tenekkul*) – madje dhe për publikun² - nga një medhheb në tjetrin, si edhe përzgjedhjen e ekspertëve (*tekhajjur*) ose arnimit të qëndrimit (*telkiif*) nga medhhebe të ndryshme, gjë që bëhet shpesh edhe në asamblatë bashkëkohore të Fikhut nga dijetarë që i janë kushtuar plotësisht një medhhebi të caktuar.

Lidhur me konceptin e transferimit nga një medhheb në tjetrin, Imam Ibn Nuxhejm el-Hanefi shkruan:

“Është e lejueshme që personi të ndjekë cilindo muxhtehid³ që do, edhe pas kodifikimit të medhhebeve siç është rasti sot. Po ashtu është e lejueshme të transferohet nga medhhebi i tij, por jo me qëllim që të kërkojë lëshimet (*rukhas*). Nëse do ta bënte këtë, a do ishte ai një i devijuar (*faasik*)? Lidhur me këtë ka dy qëndrime. Komentuesi tha se qëndrimi më i mbështetur është se ai nuk do të ishte një i devijuar dhe Allahu e di më së miri. Në fillim të *et-Tetaarkhanijeh*, autori shkroi dy kaptina rreth vendimeve fetare (fetvave); një përmbledhje e së parës do të ishte se Ebu Jusuf konsideronte se dhënia e fetvave është e lejueshme vetëm për një muxhtehid, kurse Muhamedi (esh-Shejbani) e lejoi këtë për këdo që më shumë ka qëndrime të sakta sesa gabime. Është përcjellë nga el-Iskaaf se më i dituri në qytet s’mund të justifikohet për shmangien nga dhënia e fetvave.”⁴

Imam Zekerijaa el-Ensaari esh-Shaafi tha:

“Është e lejueshme për një jo-muxhtehid të ‘ndjekë cilindo nga muxhtehidët, kur medhhebet të jenë të kodifikuara sikurse janë sot.’ Po ashtu ata mundin të ndjekin secilin prej muxhtehidëve në disa çështje, meqë Sahabët herë pyetnin njërin, herë tjetrin nga mesi i tyre, pa u qortuar ky veprim (nga ndonjëri prej Sahabëve). ‘Personi po ashtu mund të transferohet nga medhhebi në të cilin është’ në një tjetër, pa qenë kusht që ai të ndjekë më të dijshmin ose të

¹ *Mexhmu el-Fetaawaa* 3/80. Hadithi i cituar nuk konsiderohet i saktë.

² *Et-Takrir wel-Tehbir ala Tahrir el-Kemaal* 3/352.

³ Personi i kualifikuar për të ushtruar aftësitë intelektuale (ixhtihad) në vlerësimin e ligjit islamik. (Shënim i përkthyesit)

⁴ *El-Bahr er-Raa’ik* 6/292. *Et-Takrir wel-Tehbir* 3/352.

zgjedhë ndonjërin prej tyre, si në rastin kur ai herë ndjek njërin në *ixhtihadin* e bërë lidhur me Kiblen, herë ndjek dikë tjetër. Mirëpo, ai nuk bën të kërkojë lëshime, sepse mbledhja e lëshimeve e dobëson në kryerjen e detyrave fetare. ‘Pra, nëse ai zgjedh nga medhhebe të ndryshme, a do të ishte një i devijuar (*faasik*)?’ Ka dy qëndrime dhe më i mbështeturi duket të jetë se ai nuk është i devijuar. Mirëpo, nëse personi është nga gjeneratat e vona, me sa duket, do të jetë një i devijuar me siguri.”⁵

Edhe Hanbelitë pajtohen me këtë koncept (të transferimit). Ebu el-Khataab el-Kelodhani (rh), madje, citon një konsensus për këtë.⁶ El-Kadi ebu Ja’la (rh) citon disa transmetime nga Imam Ahmedi, ku ai lejon studentët e tij dhe të tjerët që e pyesin të kërkojnë lëshime në fetva me anë të dijetarëve të tjerë, duke i referuar ata nganjëherë tek Abdul-Wehhab el-Weraak, te Is’hak ose te Ebu Theur, madje dhe duke i lejuar të pyesin cilindo nga dijetarët në tubimet e dijetarëve.⁷ Shihet qartë se për Ebu Ja’lan (v.458 H) ky koncepti nuk qe kufizuar vetëm në katër medhehebet.

Përdorimi i qëndrimeve (pikëpamjeve) të dobëta ose të paautorizuara

Edhe nëse e konsiderojmë si të dobët një pikëpamje, ajo mund të adoptohet për të lehtësuar ndonjë vështirësi, nëse plotësohen kushte të caktuara, të cilat i gjejmë në vargjet vijuese nga autori Malikij i *Meraaki es-Su’uud*:

“Sepse ndonjë nevojë e menjëhershme ose një domosdoshmëri mund t’i shtrëngojë njerëzit të veprojnë sipas një pikëpamjeje të tillë (të dobët), nëse ajo nuk është tejet e dobët dhe vërtetohet se ka dal nga një muxhtehid, ndërsa personi i shtrënguar është i sigurt se ka nevojë të menjëhershme për të.”⁸

Këtyre kushteve mund t’u shtohen edhe dy të tjera, të cilat el-Karaafi i citoi nga dijetarë të mëhershëm Malikij:

1. Që personi të mos kërkojë lëshime në çdo anë

Kjo mund të jetë pjesë e kushtit të lartpërmendur – pranisë së një nevoje. Kështu, personi nuk bën të kërkojë të gjitha qëndrimet e dijetarëve të mëhershëm, me qëllim që të gjejë qëndrimin më të lehtë lidhur me një çështje. Ky është qëndrimi i shumicës dërmuese të dijetarëve. Vetëm një pakicë prej dijetarëve e lejuan këtë, gjë që ata ia atribuuan edhe Umer ibn Abdul-Azizit, i cili tha:

“S’do të doja që Sahabët e të Dërguarit ﷺ të mos kishin mospajtime, se, sikur ata të ishin pajtuar rreth një mendimi, njerëzit do të kufizoheshin shumë. Ata

⁵ *Esna el-Metaalib fi Sherh Rewd et-Taalib* nga Zekerijaa el-Ensaari, Kairo, Dar el-Kitab el-Islami 4/286.

⁶ *Et-Temhid* nga el-Kelodhani 4/334.

⁷ *El-Uddeh fi Usul el-Fikh* nga Ebu Ja’la el-Ferraa 5/1571. Marrë nga Shamilah (softuer kompjuterik).

⁸ *Nashr el-Bunuud ala Meraaki es-Su’uud* nga Abdullah ibn Ibrahim el-Alewi 2/270-270. Marrë nga Shamilah (softuer kompjuterik).

(sahabët) janë udhëheqës që duhet ndjekur dhe, nëse personi adopton mendimin e ndonjërit prej tyre, kjo nuk do të ishte e dënueshme.”⁹

Mirëpo, shumica e dijetarëve e interpretojnë këtë thënie në mënyrën që personi të mund të marrë mendimin më të lehtë të një muxhtehidi të kualifikuar, nëse kjo e kursen nga një vështirësi, por jo dhe që thjesht të përzgjedhë secilin qëndrim më të lehtë që gjen.

2. Që personi të mos formojë një qëndrim të refuzuar me konsensus (kjo vlen më së shumti në rastin e *telfiik* [arnimit ose përzierjes së qëndrimeve të ndryshme])

El-Karaafi përcolli me miratim nga ez-Zenaati se të tri kushtet për bërjen të lejueshëm të transferimit nga një medhheb në tjetrin është që: (1) personi të mos arnojë qëndrimet e medhhebeve të ndryshme në mënyrën që prodhon një qëndrim të refuzuar me konsensus, (2) që personi i cili bën *telkiif* të besojë në vlerën e ndjekjes së muxhtehidit, dhe (3) që ai të mos zgjedhë lehtësimet e të gjitha medhhebeve. El-Karaafi komentoi se lehtësimet që nuk bën të merren janë ato, që janë të pabaza dhe mund të anulohen, edhe nëse bëhen nga një gjykatës.¹⁰

Po ashtu *telkiif* (arnimi) që çon në formimin e një qëndrimi të refuzuar nga të gjitha medhehebet e integruara, duhet të ndalohet vetëm në raste të caktuara. Nëse personi ndjek verbazi (*taklid*) një imam në disa pika të një transaksioni shitblerës dhe ndjek një tjetër imam në pika të tjera, kjo marrëveshje ende duhet të jetë e vlefshme, përveç nëse pikat (nenet) përjashtojnë njëra-tjetrën ose shkaktojnë pabarazi a devijim të papranueshëm për objektivat e Sheriatit. Kjo bazohet në qëndrimin më të mbështetur se person i rëndomtë s'ka medhheb.¹¹ Një shembull i arnimit të ndaluar është rasti kur dikush, duke cituar Imam Malikun, kryen aktin martesor pa dëshmitarë dhe, duke cituar shumicën e dijetarëve, pa njoftim publik të këtij akti. Kjo martesë do të ishte një marrëdhënie e fshehtë, që konsiderohet e paligjshme nga të gjithë. Një tjetër shembull është rasti kur personi zbaton për vetveten standarde të ndryshme nga ato që ka për të tjerët, siç është kërkimi i zbatimit të së drejtës së shitjes së pronës fqinjit më të afërm (përpara të tjerëve) ndërsa refuzohet zbatimi i kësaj të drejte atëherë kur një fqinj tjetër synon ta përdorë këtë të drejtë kundra tij.

Duhet të jetë e qartë se këta shembuj janë të ndryshëm nga rasti i një personi të rëndomtë i cili pyet dy myftinj për dy çështje të ndryshme lidhur me abdesin dhe të marrë, fjala vjen, përgjigjen nga myftiu Shafit se fshirja (*mes'h*) e cilësdo pjesë së kokës mjafton dhe përgjigjen tjetër nga një myfti Hanefij se prekja e femrës (nga mashkulli) nuk prish abdesin. Nëse personi merr abdes sipas pozicionit Shafit dhe prek një femër pa eposh, ai do të ketë ruajtur abdesin sipas të gjithave medhhebeve. Pra, pavarësisht nga kjo, abdesi i tij

⁹ *Xhaami Bejaan el-Ilm we Fadlihi* nga Ibn Abdul-Berr 2/901. Marrë nga Shamilah (softuer kompjuterik).

¹⁰ *Sherh Tenkih el-Fusuul*, f.432.

¹¹ *Shih el-Bahr el-Muhit* nga ez-Zerkeshi 8/375, Daar el-Kutbi, 1997. Marrë nga Shamilah (softuer kompjuterik); *Haashijet Ibn Abidin*, botimi i 2-të, nga Ibn Abidin, Bejrut, Daar el-Fikr 1/48.

ende është i vlefshëm,¹² duke qenë se këto çështje as nuk varen nga njëra-tjetra, as nuk përjashtojnë njëra-tjetrën. Ndonëse shumica e dijetarëve pas shekullit të dhjetë (hixhri) ndalonin nga kjo, ne nuk gjejmë të përmendet ky ndalim para shekullit të shtatë.¹³ Mes Sahabëve gjithashtu kishte konsensus për atë se, ai që pyeste Ebu Bekrin dhe Umerin për ndonjë çështje, mund të pyeste edhe Muadhbin, edhe Ebu Hurejren ose të tjerë për ndonjë çështje.¹⁴ Ata asnjëherë nuk kufizuan këtë në çështjet që s'i përkasin të njëjtit akt të adhurimit. Pa lejimin e *telkiif* (arnimit) të rregulluar, shumë kontrata bashkëkohore nuk do të ishin të lejueshme as sipas edhe një medhhebi të vetëm. Do të zhvilloheshin vështirësi të mëdha dhe gjerësia e trashëgimisë sonë juridike do të humbte vetinë e rëndësishme të lakueshmërisë dhe të përshtatshmërisë.

Këtu mund të shtohet edhe një kusht: që ndjekësi i qëndrimit më të dobët të mos ketë dije të sigurt për gabueshmërinë e atij qëndrimi. Imam Shafi tha:

“Muslimanët janë të një mendjeje se personit që vihet në dijeni për Sunetin e të Dërguarit të Allahut ﷺ nuk i lejohet ta lërë atë për thënien e dikujt tjetër, pavarësisht se kush mund të jenë ai.”¹⁵

Ndërsa Imam Shafiu e kishte për dijetarët, e njëjta gjë vlen për të gjithë njerëzit që janë të sigurt për gabueshmërinë e ndonjë qëndrimi.¹⁶ Waabiseh bin Ma'bed (ra) tha: “Shkova të i Dërguari i Allahut dhe ai tha: ‘Ti erdhe të pyesësh për të drejtën.’ U përgjigja: ‘Po.’ Ai tha:

‘Pyet zemrën tënde. E drejtë është ajo që rehaton shpirtin dhe qetëson zemrën. Mëkatim i qëllimtë (*ithm*) është diçka që të bën të ngurrosh dhe ta trazon gjoksin, edhe nëse njerëzit vazhdimisht të japin fetva për të (së është në rregull ta bësh).’¹⁷

¹² Shih *el-Fikh el-Islaami we Adiletuhu* nga Wehbeh ez-Zuhejli, Damask, Daar el-Fikr 1/106-107.

¹³ Ibid.

¹⁴ *Sherh Tenkih el-Fusuul*, f.432.

¹⁵ *I'laam el-Muwekki'in* 1/6.

¹⁶ Shih *et-Tekrir wet-Tehbir* 3/352.

¹⁷ Hadith i besueshëm i përcjellë nga Imam Ahmed dhe ed-Daarimi, me një zinxhir të mirë transmetimi (Sunnah.com/nawawi40/27)